



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Në kuadër të promovimit të kulturës së konkurrencës, mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg Autoriteti i Konkurrencës zhvilloi sot, më datë 19 dhjetor 2023, një takim me përfaqësues nga Shoqata Biznesi dhe Dhoma Tregtie me temë “Korniza legislative/ligjore për mbrojtjen e konkurrencës dhe nevoja për një rol më aktiv të Autoritetit të Konkurrencës në fushën e biznesit”.

Gjatë këtij takimi Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba prezantoi për të ftuarit propozimet dhe ndryshimet ligjore të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, specifikat kryesore të amendimit të legjislacionit dhe nevojën për një rol proaktiv të AK në funksion të biznesit.

Gjithashtu, përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës paraqitën në mënyrë të detajuar për të pranishmit, prezantime për “Programin e përputhshmërisë me rregullat e konkurrencës” dhe Programin e lehtësimit nga gjrobat” në një bashkëbisedim interaktiv me pjesëmarrës nga fusha e biznesit.

Në këtë organizim morën pjesë përfaqësues nga dhomat e tregtisë, si ajo shqiptare, gjermane, amerikane etj, zyra ligjore dhe biznese të interesuara për njohjen më në detaje të legjislacionit mbi mbrojtjen e konkurrencës në Shqipëri.

Ky aktivitet shërbeu për forcimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive për mirëfunksionimin e tregut si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës me botën e biznesit, me synim nxitjen e ndërgjegjësimit për minimizimin e praktikave antikonkurrese. Aktivitete të tilla do të vijojnë të zhvillohen dhe vitin pasardhës, si një traditë e AK për të lidhur ura komunikimi me grupet e interesit, me qëllim njohjen dhe promovimin e kulturës së konkurrencës.

Për më tepër, ju lutem konsultoni faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës në <http://caa.gov.al>.